



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Dental Chamber of Kosovo

KONFERENCA E V-të STOMATOLOGJIKE -
VIRTUALE
“STOMATOLOGJIA NË RRETHANA PANDEMIE”
THE V-th DENTAL CONFERENCE - VIRTUAL
“DENTISTRY DURING PANDEMICS”

20 Mars 2021
March 20th, 2021



Në bashkëpunim me Shoqatën e Stomatologëve të Republikës së Kosovës

Këshilli organizativ – *Organizing Committee*

Dr. Sci. Kastriot Meqa – Kryetar, *President*

Dr. Dardan Bekteshi

Dr. Nora Berisha

Fjala hyrëse e Kryetarit të OSK-së

Te nderuar kolege dhe kolegë stomatolog,

Eshtë kënaqësia ime t'ju përshëndes për pjesëmarrje në Konferencën e V-të Stomatologjike-Virtuale, të cilën e organizon OSK në bashkëpunim me Shoqatën e Stomatologëve të Kosovës.

Sot është 20 Marsi që shënon Ditën Botërore të Shëndetit Oral. Edhe OSK dhe Shoqata e Stomatologëve të Kosovës i bashkohet kësaj dite botërore duke e promovuar edhe në Kosovë ditën e shëndetit oral nëpërmjet kësaj konference.

Viti 2020 filloi me pandeminë Covid-19 që e preku të gjithë botën, jeta e të gjithëve ka ndryshuar dhe po kështu edhe mënyra e organizimit të konferencave dhe eventeve tjera profesionale dhe shkencore. Megjithëse shpërthimi i COVID-19 ka paraqitur shumë kufizime dhe sfida, unë jam i lumtur që sot po organizojmë Konferencën e V-të Stomatologjike-Virtuale.

Kjo konferencë e këtij lloji do të ketë ligjërues nga vendet e ndryshme, si SHBA, Kroacia, Shqipëria, Maqedonia Veriore dhe ligjërues vendor.

Konferenca është akredituar nga KEVP me 15 pikë për ligjëruesit dhe 10 pikë për pjesëmarrje. Ky vlerësim është njohje e standardeve të larta të përmbajtjes akademike të ligjëruesve të konferencës.

Dhe krejt në fund të fjalës sime shpresojë dhe besojë që së shpejti t'ju ofrojmë mundësi për t'u takuar dhe bashkëvepruar mes veti si profesionistë të këtyre fushave.

Besoj të keni sot një ditë të shkëlqyeshme!

Me respekt,

Prof. Dr. Blerim Kamberi

Kryetar i Odës së Stomatologëve të Kosovës

PËRMBAJTJA

CONTENT

SHQIP **6-26**

ENGLISH **28-49**

Programi i Konferencës

20.03.2021

09.45 HAPJA E KONFERENCËS

LIGJËRATAT PLENARE

10.00 – 10.40 **LP1 – Prof. Asoc. Ferit Koçani** (Universiteti i Prishtinës)
STOMATOLOGJIA GJATË PANDEMISË COVID-19

10.50 – 11.30 **LP2 – Prof. Asoc. Edit Xhajanka** (Universiteti i Mjekësisë, Tiranë) -
PËRCAKTIMI I HAPËSIRËS SË EKUILIBRIT PROTETIK NË PROTEZAT
E LËVIZSHME

11.40 – 12.20 **LP3 – Prof. Dr. Sc. Marinka Mravak Stipetić** (Universiteti i Zagrebit,
Kroaci) LEZIONET E MUKOZËS ORALE GJATË TRAJTIMIT
ORTODONTIK

12.30 – 13.10 **LP4- Prof. Asoc. Çeljana Toti** (Universiteti i Mjekësisë, Tiranë) -
MENAXHIMI I TRAUMAVE DENTARE NË ORTODONCI

13.20 – 14.00 **LP5 – Asst. Prof. Irina Dragan** (SHBA- Tufts University School of Dental
Medicine) - INTEGRIMI I KLASIFIKIMIT TË AAP/EFP TË VITIT 2018 NË
PRAKTIKËN KLINIKE

14.00 – 15.00 *Pauza*

15.00 – 15.40 **LP6 – Prof.Dr. Agim Begzati** (Universiteti i Prishtinës) - PËRKUJDESJA
STOMATOLOGJIKE E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

15.50 – 16.30 **LP7 – Prof. Ass. Kenan Ferati** (Universiteti i Tetovës) - DEFEKTET
KOCKORE TË NOFULLAVE - TRETMANI I TYRE

16.40 – 17.20 **LP8 – Prof. Ass. Miranda Stavileci** (Universiteti i Prishtinës) - VLERËSIMI
I PËRPUNIMIT DHE OBTURIMIT TË KANALIT ME TEKNIKA TË
NDRYSHME

17.30 MBYLLJA E KONFERENCËS

LIGJËRATAT PLENARE

Prof. Asoc. Ferit Koçani

Ferit Koçani, i lindur në Pejë me 7 Dhjetor 1955. Studimet themelore në Fakultetin i Mjekësisë, Dega e Stomatologjisë i përfundoi në vitin 1984, në mars të po atij viti zgjedhet Asistent Praktikant, kurse studimet pasuniversitare të magistraturës në Fiziologji Normale Patofiziologjike dhe Eksperimentale i kreu në vitin 1989. Doktoroi në vitin 2004, aktualisht është Profesor i Asocuar dhe specialist për Sëmundje të Dhëmbit dhe Gojes.



Anëtar i Këshillit Drejtues të QKUK në vitin 1999 dhe Drejtor/Koordinator i Klinikave të Stomatologjisë deri në vitin 2000. Kryeshef i Shërbimeve Shëndetësore Stomatologjike në QKSUK nga viti 2004 deri në 2009. Prodekan për Mësim dhe Çështje Akademike në Fakultetin e Mjekësisë 2007-2010; udhëheqës i procesit mësimor dhe çështjeve akademike, Udhëheqës i Katedrave të FM, Bartës i procesit të Vetvlerësimit të brendshëm të Kurikules në FM, përpilues i projektit dhe Kurikules për studime pasuniversitare të PhD, udhëheqës i ndryshimit të Kurikules në vitin akademik 2007/08 në FM në të gjitha degët e studimeve themelore të FM. Bashkpërpilues i Modulit Menaxhimi i Rrezikut në Shëndetësi në kuadër të Tempus Master Science Development Program për Menaxhim në Shëndetësi ndërmjet Universitetit Biomjekësorë Vienna në Austri dhe Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Mjekësisë. Hulumtimet shkencore në endodoncion në kuadër të studimeve të magistraturës dhe doktoraturës me aplikimin e Skanimit Elektron Mikroskopit për vlerësimin e teknikave të instrumentimit dhe protokollit për irrigim, mbushjen dhe mbylljen e sistemit të kanaleve të rrënjës së dhëmbit.

Si autor dhe koautor ka publikuar hulumtime në revista me recensio ndërkombëtar, kumtesa në kongrese ndërkombëtare me publikim në zhurnale prestigjioze. Pjesëmarës në konferenca dhe simpoziume ndërkombëtare dhe regjionale me kumtesa nga hulumtimet në endodoncion dhe antropologji paleopatologjike. Është mentor i jashtëm në kuadër të studimeve pasuniversitare të PhD në Fakultetin e Stomatologjisë të Universitetit të Zagrebit, Kroaci.

STOMATOLOGJIA GJATË PANDEMISË COVID-19

Coronaviridae – shok i vjetër, armik i ri!

Marcus Tullius CICERO (106-43BC):

“Salus populi suprema lex esto”- “Shëndeti i popullit është ligji suprem”

Coronaviruset (CoVs), të njohura që nga viti 1960, mund të infektojnë dhe shkaktojnë sëmundje si në kafshë ashtu edhe në njerëz.

Përhapja recente e sindromës së rëndë akute respiratore Sars-CoV-2, sëmundje infektive Covid-19, ka shkaktuar shqetësim global të shëndetit publik. Pavarësisht nga përpjekjet globale për të parandaluar përhapjen e sëmundjes, shpërthimi është ende në rritje për shkak të modelit të përhapjes së komunitetit të këtij infeksioni.

Organizata Botërore e Shëndetit (OBSH/WHO) shpalli përhapjen globale si pandemi në KATEGORINË JASHTËZAKONISHT INFEKTIVE të SARS-CoV-2 dhe sëmundjen e saj shoqëruese (COVID-19) si emergjencë shëndetësore publike.

Karakteristikat Epidemiologjike

Në trupin e njeriut coronavirusi (SARS-CoV-2) është jashtëzakonisht i pranishëm në sekretimet nazofaringeale (hundë dhe fyt) dhe pështymën e pacientëve të prekur. Prandaj, bazuar në të dhënat epidemiologjike aktuale, coronaviruset përhapen përmes sperklave të mëdha (5-12 µm) gjatë frymëmarrjes (gjatë të folurit, kurse kolla dhe tështima nxjerrin edhe më shumë sperkla), përmes kontaktit të drejtpërdrejt (me sekretet nazofaringeale, pështymën dhe gjakun në gojë), por gjithashtu dyshohet edhe për mënyra tjera (studimet kanë treguar praninë e SARS-CoV-2 në pështymë dhe feces/jashtëqitje të pacientëve të infektuar).

SARS-CoV-2 mund të lidhet me receptorët e enzimës konvertuese të angiotenzinës 2, të cilat janë shumë të përqendruara në gjëndra pështymore, ky mund të jetë shpjegim i mundshëm për praninë e SARS-CoV-2 në pështymë.

Rekomandime për Menaxhim

Nevoja për menaxhimin e rrezikut, përveç që është detyrim ligjor për të siguruar mjedis të sigurt që nuk përbën rrezik për punëtorët shëndetësor dhe mjedisin, ka për synim sigurinë e pacientit

Nën premisën e masave adekuate mbrojtëse, të përshkruara dhe rekomanduara për masat preventive epidemiologjike gjatë punës klinike me pacientë, kanë dhënë rezultatet e pritura.

Jemi të vetëdijshëm se këto vendime dhe shqetësimet për shëndetin publik edhe mund të përkeqësohen. Prandaj, mbrojtja e shëndetit publik është sakrificë personale në dobi të përgjithshme.

Prof. Assoc. Edit Xhajanka

Prof. Assoc. Edit Xhajanka është diplomuar në fushën e Stomatologjisë, me rezultate të shkëlqyera, në Fakultetin e Mjekësisë, Departamenti i Stomatologjisë, në Tiranë, në vitin 1990. Ajo ka marrë specializimin pasuniversitar në Protetikë fikse dhe mobile. Prof. Edit Xhajanka ka përfunduar "Masterin Teorik dhe Praktik" në Padova dhe në Universitetin e Barit, Itali (2001). Në vitin 2003 ajo përfundoi me rezultate maksimale masterin "Protezat Biofunktionale". Ajo ka ndjekur kurse të ndryshme specializimi brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 2009 iu dha titulli "Doktor i Shkencave". Në Qershor 2014, Prof. Edit Xhajanka mori titullin "Profesor i Asociuar".



Interesat e hulumtimit: Aktiviteti i hulumtimit është i përqendruar në Sistemin Protetik Bio funksional, protetikën fikse dhe mobile.

Përvoja: Gjatë periudhës 1990-1997 ajo ka punuar si mjeke stomatologe në Klinikën Stomatologjike Universitare. Që nga viti 1997 ajo ka punuar si Pedagoge në Departamentin e Protetikës dhe përgjegjëse e lëndës "Protezat totale të lëvizshme", në Departamentin e Protetikës Stomatologjike, Fakulteti i Mjekësisë Dentare.

Pozicioni aktual - Nga Prilli 2016 ajo është Dekane e Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë.

Prof. Edit Xhajanka është lektor i klasave të specializimit në fushën e Protetikës. Ajo ka përfunduar kualifikime të ndryshme në vende të ndryshme të Evropës. Ajo është autore dhe bashkëautor e disa librave universitarë dhe Kryeredaktore e "Revistës Shqiptare të Stomatologjisë". Ajo është autore dhe bashkëautore e disa librave shkollorë dhe monografive. Ajo ka ligjruar në shumë kongrese dhe konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare dhe ka botuar një numër të madh artikujsh në revistat profesionale ndërkombëtare dhe shqiptare.

Ajo është anëtare e Bordit Redaktues të UMT, anëtare e Bordit Shkencor të Buletinit të Shkencave Mjekësore, UMT, anëtare e Bordit Shkencor të Revistës Ballkanike Stomatologjike. Prof. Xhajanka është anëtar i Shoqatës Evropiane të Protetikës; Nënkyetar i Shoqatës Protetike

Shqiptare dhe Zëvendës Këshilltar i Shoqatës Ballkanike Stomatologjike. Ajo është një profesore vizituese në Universitetin e Tetovës, Universitetin “Aldo Moro”, Bari dhe në Universitetin Unicamillus, Romë. Ajo është kryetare e Komisionit të Etikës dhe Gjykimit Disiplinor të Urdhrit të Stomatologëve të Shqipërisë.

PËRCAKTIMI I HAPËSIRËS SË EKUILIBRIT PROTETIK NË PROTEZAT E LËVIZSHME

Në situata të caktuara klinike, suksemi dhe qëndrueshmëria e protezës totale janë të diskutueshme dhe shumë të vështira të arrihen, veçanërisht në rastet klinike me faktorë anatomikë të disfavourshëm, atrofi të shprehur, nofulla të vogla etj. Metoda të ndryshme janë përdorur për rritjen e qëndrueshmërisë së protezave totale, në të cilat mund të përmendim protezat ekstensive, vendosjen e implanteve, përdorimin e adezivëve etj. Leksioni ka si qëllim të paraqesë një koncept të ri lidhur me rritjen e qëndrueshmërisë së protezës totale. Ky koncept ka të bëjë me mënyrën se si mbështeten në sipërfaqet e protezës së lëvizshme muskujt dhe indet e buta periprotetike. Pavarësisht se bëhet fjalë për muskuj dhe struktura të lëvizshme, nëpërmjet kësaj teknike, ne i shfrytëzojmë këta muskuj për të stabilizuar protezën. Koncepti i hapësirës së ekuilibrit protetik dhe regjistrimi i saj në mënyra të ndryshme, është qëllimi bazë i këtij leksioni. Në leksion do të paraqiten mënyrat e regjistrimit të hapësirës neutrale, materialet e ndryshme që mund të përdoren, si dhe indikacionet e aplikimit të saj. Regjistrimi i hapësirës së ekuilibrit është shumë i rëndësishëm sidomos në rastet e atrofisë ekstreme mandibulare, mandibuloektomisë, glosektomive të pjesshme, protezave të lëvizshme mbi implante, në pacientë me Parkinson, me kontroll të ulët neuromuskular, episode të Strokut, në rastet e dëmtimit të inervimit motorik të muskujve të gojës dhe të fytyrës nga ndërhyrjet kirurgjike në tru, etj. Metoda e masës terciare është e thjeshtë dhe jep rezultate të kënaqshme, veçanërisht në rastet ku faktorët anatomikë të fushës protetike nuk ofrojnë kushte për qëndrueshmërinë e protezës. Ajo rrit forcat e tensionit sipërfaqësor, qëndrueshmërinë e protezës dhe komoditetin e pacientëve.

Prof. Dr. Marinka Mravak-Stipetić

Prof. Dr. Marinka Mravak-Stipetić, DMD, MSc, PhD është profesoreshë e rregullt në Shkollën e Mjekësisë Dentare, Universiteti i Zagrebit, e përfshirë në studime pasuniversitare dhe specialistike në patologjinë orale dhe dentare dhe periodontologjinë dhe klinikiste në Klinikën Dentare UHC Zagreb. Fusha e saj më e ngushtë e punës janë mjekësia orale dhe patologjia, diagnostifikimi dhe terapia e mukozës orale dhe sëmundjeve të gjëndrës së pështymës të shoqëruara me sëmundje sistemike dhe në pacientë me shëndet të komprometuar, diagnostifikimi molekular i sëmundjeve orale dhe komplikimeve orale pas transplantimit, si grafti kronik kundrejt sëmundjes së nikoqirit, brenda të cilit ajo zhvillon bashkëpunim multidisiplinar. Ajo është themeluese dhe drejtuese e Qendrës së Referencës për Sëmundjet e Mukozave Orale të Ministrisë Kroate të Shëndetësisë dhe UHC Zagreb. Ajo është një anëtare e ekipit multidisiplinar për studimin e sëmundjes kronike të graftit kundrejt nikoqirit në UHC Zagreb, themelues dhe president i Shoqatës Kroate për Bashkëpunim Multidisiplinar në Mjekësinë Dentare në Shoqërinë Kroate të Mjekëve. Ajo kreu trajnimet në NIH, Bethesda, SHBA, në Klinikën Universitare Eppendorf, Hamburg, Gjermani dhe në Kolegjin Mjekësor në Graz, Austri. Ajo është pjesëmarrëse aktive dhe ligjëruese e ftuar e shumë takimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, organizatore dhe lektore në kurse të edukimit të vazhdueshëm dhe simpoziume multidisiplinare. Ajo është autore e 125 punimeve shkencore dhe profesionale në fushën e mjekësisë dentare, 16 kapitujve në libra shkencorë dhe përkthyes dhe redaktore e edicionit të parë kroat të Librit Shkollor të Universitetit Amerikan dhe Atlasit të sëmundjeve të gojës. Ajo është redaktore dhe autore e Doracakut Universitar "Shëndeti oral me anë të shëndetit të përgjithshëm - një qasje multidisiplinare" botuar së fundmi nga Oda e Stomatologëve të Kroacisë.



LEZIONET E MUKOZËS ORALE GJATË TRAJTIMIT ORTODONTIK

Lezionet e mukozës orale në bartësit e pajisjeve ortodontike janë gjetje të zakonshme në praktikën e përditshme dentare. Gjatë trajtimit ortodontik lezionet orale mund të kenë tre shkaqe kryesore: traumatike, infektive ose reaktive. Reaksionet anësore gjatë terapisë ortodontike ndodhin në një shtrirje nga acarimi i mukozës deri te ulçeracionet, dhimbjet dhe shqetësimet, të cilat mund të ndikojnë në rrjedhën e terapisë dhe bartjen e pajisjes. Lezionet orale mund të rezultojnë gjithashtu nga ndërveprimet e lëgurave të telave dhe indeve orale. Këto ndërveprime rezultojnë nga aderimi bakterial, efektet toksike, subtoksike dhe alergjike të shkaktuara nga jonet metalike dhe alergjia. Gjatë trajtimit me pajisje fikse ortodontike, situata sfiduese e higjienës orale për shkak të ushqimit të bllokuar dhe mbetjeve orale rreth breketave mund të kontribuojë në zhvillimin e inflamacionit gingival. Ndërveprimet e drejtpërdrejta midis pajisjeve ortodontike dhe indeve gingivale dhe periodontale mund të paraqesin një sfidë të konsiderueshme. Megjithëse të dhimbshme dhe të pakëndshme, lezionet shërohen shpejt, shpesh pa terapi lokale për shkak të qarkullimit të shpejtë të mukozës orale në pacientë të shëndetshëm ortodontikë. Sidoqoftë, vlerësimi i lezionit dhe diagnoza e duhur e lezionit të mukozës orale bazohet në një anamnezë të detajuar dhe ekzaminim klinik. Kontrollat e rregullta gjatë trajtimit ortodontik duhet të përfshijnë ekzaminimin e tërë mukozës orale. Gjithashtu, pacienti duhet të pyetet nëse ai ose ajo kishte ndonjë shqetësim ose dhimbje gjatë bartjes së pajisjes ortodontike, në mënyrë që stomatologu ose ortodonti të jetë në gjendje të zbulojë lezionin dhe ta trajtojë atë në kohën e duhur. Ky prezantim do të tregojë lezionet orale më të zakonshme gjatë trajtimit ortodontik dhe mënyrën e menaxhimit të tyre nëse është e nevojshme.

Prof. Asoc. ÇELIANA TOTI

- Ndjek studimet e larta pranë Fakultetit të Mjekësisë, Dega Stomatologji nga 1991-1996.
- Diplomoi si Mjeke-Stomatologe më 1996 me rezultate të shkëlqyera
- 1997 fillon punën si asistente në Departamentin e Stomatologjisë, Dega Ortodonci
- 1998...pedagoge dhe lektore në Departamentin e Stomatologjisë, Dega Ortodonci
- 2003 përfundon studimet në Shkollën e Lartë Pasuniversitare (SHPU) me rezultate maksimale, duke fituar titullin Master me temën: "Anomalitë e numrit të dhëmbëve"
- 2014-2017 Specializim 3-vjeçar në Ortodonci, Universiteti "Aldent"
- Edukimi në vazhdimësi duke ndjekur kurse specializimi, leksione dhe seminare në SHBA dhe në Evropë
- Pjesëmarrëse aktive në aktivitetet shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë
- Kryetare ose anëtare e bordeve organizative dhe shkencore në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë Shqipërisë
- Autore dhe bashkëautore në më shumë se 150 prezantime shkencore, përfshirë këtu edhe prezantime si lektore e ftuar në aktivitete ndërkombëtare
- Autore dhe bashkëautore e më shumë se 50 punimeve shkencore të publikuara në Revista Shkencore shqiptare dhe të huaja
- Autore e 3 teksteve mësimore në formën e ciklit të leksioneve për studentët dhe bashkëautore në një tekst mësimor
- Anëtare e Unioneve dhe Shoqatave shqiptare dhe të huaja:
(SHOSH, WFO, FEO, BAOS, SIDO, AAA, SHDSH, BASS)
- 2003...anëtare e bordit editorial të Revistës Stomatologjike Shqiptare, Revistë Periodike e Fakultetit të Mjekësisë Dentare
- 2011- 2014, anëtare e bordit editorial të Revistës Mjekësore, Revistë Shkencore e Fakultetit të Mjekësisë



- 2015...antëtare e bordit editorial të Dental Leader Corsi Journal
- 2005 fiton gradën shkencore "Doktor i Shkencave" me studimin "Agenezia dentare në denticionin permanent"
- 2006- 2014, Zv/Presidente e Shoqatës së Ortodontëve Shqiptarë
- 2014... Presidente e Shoqatës së Ortodontëve Shqiptarë
- 2017-2018 Zv/Presidente e Shoqatës Ballkanike të Specialistëve Ortodontë (BAOS)
- 2020-2021 Zv/Presidente e Shoqatës Ballkanike të Specialistëve Ortodontë (BAOS)
- Titullare e lëndës Ortodonci Paraklinike pranë FMD (Fakulteti i Mjekësisë Dentare)
- Lektore për lëndën e Ortodoncisë në Programin e Studimeve të Thelluara Pasuniversitare
- Drejtore teknike në kurse trajnimi të zhvilluara nga kompani prestigjioze
- Udhëheqëse shkencore për tezën master
- Udhëheqëse shkencore në tema diplomash me studentët
- Drejtuese dhe pjesëmarrëse në projekte të ndryshme
- 2014 fiton titullin "Profesor i Asociuar"
- 2014- 2016 emërohet Drejtuese e Departamentit të Ortopedisë Stomatologjike pranë Fakultetit të Mjekësisë Dentare
- 2016... zgjidhet Drejtuese e Departamentit të Ortopedisë në Fakultetin e Mjekësisë Dentare
- Eksperte pranë QKEV (Qëndrës Kombëtare për Edukimin në Vazhdim), si edhe pranë ASCAL (Agjensia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë).

MENAXHIMI I TRAUMAVE DENTARE NË ORTODONCI

OBSH në 1952 përcaktoi konceptin e cilësisë së jetës (QoL) si "perceptimi i mirëfilltë dhe i qartë që një person ka për vetëveten bazuar në kontekstin kulturor dhe në vlerat mbi të cilat ajo ngrihet, lidhur me objektivat, standardet, shpresat dhe shqetësimet". Në fushën e dentistrisë, kjo do të thotë se shëndeti i mirë oral nuk përfshin vetëm mungesën e kariesit ose sëmundjeve periodontale, por edhe mirëqenien sociale dhe mentale të pacientit. Dëmtimet traumatike dentare (DTD) konsiderohen si patologjia orale e dytë më e frekvente pas kariesit për fëmijët dhe adoleshentët. Rezultatet e publikuara mbi prevalencën raportojnë vlera midis 6 % - 49%.

Studime gjejmë edhe mbi ndikimin që traumat dentare kanë mbi vetëvlerësimin dhe anën psikologjike të individëve. Tajtimi i plotë dhe përfundimtar i traumave shpesh kërkon një trajtim multidisiplinar.

Traumat dentare janë në fokusin e ortodontëve, për të hulumtuar më shumë mbi strategjitë për parandalimin e tyre duke njohur dhe studiuar faktorët predispozues. Një studim mbi traumat dentare u krye në një shkollë 9- vjeçare të Tiranës. 430 fëmijë u ekzaminuan klinikisht dhe plotësuan një pyetësor. Rezultatet e studimit do të pasqyrohen gjatë këtij leksioni duke ballafaquar të dhënat tona me ato të literaturës bashkëkohore.

Përmirësime në sigurinë e ambjentit, supervizion më i kujdesshëm i fëmijëve dhe adoptimi i politikave të sigurisë shëndetësore mund të kenë një impakt pozitiv në prevenimin e DTD. Programi i promovimit shëndetësor shkollor i OBSH ofron një zgjidhje të gjerë për traumat dentare, si një problem i shëndetit publik. Nga ana jonë si specialistrë ortodontë, fokusi mbetet njohja e faktorëve dentarë të riskut.

Prof. Ass. Irina F. Dragan, DMD, DDS, MS

Periodontiste, edukatore dhe studiues me ekspertizë të gjerë në hartimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve arsimore për të lehtësuar zhvillimin e njohurive për studentët, specialistët dhe fakultetin. Udhëheqës i njohur për aftësinë e saj për të punuar në ambiente matricë dhe bashkëpunuese për të formuar trendet në edukimin dentar, zhvillimin shkencor dhe përparimet teknologjike. Me përvojë në drejtimin e inovacioneve klinike nga koncepti të miratimi i FDA, duke përfshirë një alternativë të indeve të buta për të korrigjuar anomalitë mukogingivale. E njohur nga kolegët për zell dhe përkushtim për të mbështetur dhe trajnuar të tjerët.



ARSIMIMI

Shkolla e Mjekësisë Dentare e Universitetit Tufts, Boston, MA. - Doktor i Mjekësisë Dentare

Programi Pasuniversitar i Edukimit të Avancuar në Periodontologji - Master i Shkencave

New York University College of Dental Medicine, New York, NY. Certifikatë në Stomatologjinë Gjithëpërfshirëse

Universiteti Carol Davila, Fakulteti i Stomatologjisë, Bukuresht, RUMANI. Doktor i Mjekësisë Dentare

TRAJNIME SHITESË

Bootcamp i Liderimit të Inovacionit të Institutit të Teknologjisë në Massachusetts

Bazat e Menaxhimit të Projektit Rita Mulcahy Institute

Programi i Institutit Harvard Marcy për Edukatorët e Kujdesit Shëndetësor

Shoqata Amerikane e Edukimit Dentar / Akademia për Institutin e Liderimit Akademik për Mësimdhënie dhe Mësim

Programi i Shoqatës Amerikane të Edukimit Dentar Shoqata Amerikane e Edukimit Dentar /
Shoqata Amerikane e Kërkimit Dental Programi i Bursave Akademike të Karrierës Dentare

Instituti i Liderit të Shoqërisë Dentare në Massachusetts

EKSPERIENCA PROFESIONALE

2016- sot: Profesor asistent. Departamenti i Periodontologjisë. Shkolla e Mjekësisë Dentare e
Universitetit Tufts, Boston MA. Anëtar i fakultetit me kohë të plotë (drejtimi i mandatit), i
ngarkuar me mësimdhënien në mjediset didaktike, paraklinike dhe klinike dhe kërkimin
shkencor

2019-aktual: Drejtor i Edukimit dhe Zhvillimit Mësimor të Fakultetit. Zyra e Çështjeve
Akademike. Shkolla e Mjekësisë Dentare e Universitetit Tufts, Boston MA.

2016-sot: Perodontist. Boston. MA praktikues privat në fushën e periodontologjisë dhe
implanteve në stomatologji.

2012-2016: Asistent i Mësimdhënies. Zyra e Çështjeve Akademike / Departamenti i
Periodontologjisë. Shkolla e Universitetit Tufts e Mjekësisë Dentare, Boston MA. Përgjegjës për
mësimdhënien dhe gradimin e detyrave të studentëve për lëndët "Vlerësimi kritik i literaturës
shkencore" dhe "Hyrje në kërkime" të ofruara për studentët e Masterit të Shkencave

2006-2016: Përfaqësuesi i Studentëve Stomatologjikë dhe Rezidentëve Shoqata Evropiane e
Studentëve Stomatologjikë dhe Shoqata Amerikane e Edukimit Dentar Këshilli i Studentëve,
Banorëve dhe Fellows: Presidenti, Sekretari i Përgjithshëm, Zyrtari i Partneritetit

GJUHËT Rumanisht (gjuhë amtare), Anglisht, Spanjisht

PUBLIKIME 26 në Pubmed: <https://pubmed.ncbi.nlm.nih.gov/?term=DRAGAN+IF&sort=date>
457 citime; indeksi h 7; indeksi i10 5; Porta e Kërkimit: 18.34

INTEGRIMI I KLASIFIKIMIT AAP/EFP TË VITIT 2018 NË PRAKTIKËN KLINIKE

Në vitin 2018 Federata Evropiane e Periodontologjisë dhe Akademia Amerikane e Parodontologjisë prezantuan një klasifikim të ri të diagnozave. Ky klasifikim ka disa ngjashmëri me klasifikimin e Armitage (1999), por ka edhe ndryshime. Ky prezantim do të rishikojë konceptet kryesore të klasifikimit të ri, progresin e vendimmarrjes dhe zbatimin në raste të ndryshme klinike. Në fund të prezantimit, audienca do të jetë në gjendje të kuptojë 4 kategoritë në klasifikim.

Prof. Dr. Agim Begzati

Prof. Dr. Agim Begzati, është profesor i rregullt në Fakultetin e Mjekësisë-Dega e Stomatologjisë. Në këtë institucion u diplomua në vitin 1990. Specializon në vitin 2002 në lëmin e Pedodoncisë dhe stomatologjisë preventive. Magjistron në vitin 2003, ndërsa, titullin doktor i shkencave stomatologjike e fiton në vitin 2008.



Ka publikuar dhe prezantuar dhjetëra punime shkencore dhe profesionale, punime edukative-shëndetësor dhe vështrime. Është autor dhe realizues i disa projekteve nga lëmia e stomatologjisë preventive dhe shëndetësisë publike. Boton librin “Përkujdesja shëndetësore stomatologjike”, doracakun “Edukimi Shëndetësor oral”. Është autor kapitulli në librin universitar “Pediatria, për stomatolog” (2015). Gjithashtu, është autor kapitulli në librat me recension ndërkombëtar, *Emerging Trends in Oral Health Sciences and Dentistry* (2015) dhe *Oral health Care- Pediatric, Research, Epidemiology and Clinical Practices* (2014). Në vitin 2017, boton edhe monografinë, “Kariesi i hershem i fëmijëve”, ndërsa ka në botim librin universitar “Stomatologjia Pediatrike”.

Është anëtar i Shoqatës Evropiane për Shëndet Publik Dental dhe anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Stomatologjisë Pediatrike. Krahas punës arsimore-profesionale dhe shkencore ka ushtruar edhe detyra udhëheqëse: Prodekan në Fakultetin e Mjekësisë, Shef i Klinikës së Pedodoncisë dhe stomatologjisë preventive, Kryetar i Komitetit Specialistikë të Stomatologjisë, Anëtarë i Këshillit Drejtues të Odës së Stomatologëve të Kosovës, Kryetar i Shoqatës së Stomatologjisë Pediatrike dhe Preventive. Aktualisht është Shef i Katedrës së Pedodoncisë.

Jeton në Prishtinë. Është i martuar dhe ka dy fëmijë.

PËRKUJDESJA STOMATOLOGJIKE E FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH-së), numri i personave me aftësi të kufizuara në botë është i madh dhe në rritje. Mbi një miliard njerëz, ose rreth 15% e popullsisë së botës, kanë një formë të aftësisë së kufizuar, nga të cilat mbi 200 milionë janë fëmijë. Edhe në Kosovë është një numër i konsiderueshëm i fëmijëve me aftësi të kufizuar, duke mare për bazë edhe rrethanat nëpër të cilat ka kaluar vendi ynë.

Është dilemë se si të emërtohen këta fëmijë: fëmijë të hendikepuar, fëmijë të retarduar, fëmijë me të meta fizike ose psikike, etj. Mendojmë se term më adekuat nga aspekti etikë do të mund të jetë “fëmijë me aftësi të kufizuara” ose “fëmijë me nevoja të veçanta”. Megjithatë në literaturën mjekësore më së shpeshti haset termi “fëmijë të hendikepuar”. Hendikep nënkupton çrregullim të funksioneve normale të organizmit si pasojë e anomalive të lindura ose të fituara, lëndimeve me pasoja, sëmundjeve kronike etj.

Organizata Botërore e Shëndetësisë, fëmijë të hendikepuar definojnë atë fëmijë i cili në periudhë të caktuar kohore nuk është në gjendje që fizikisht ose mentalisht të marrë pjesë plotësisht në aktivitetet normale të moshatarëve të tij, duke përfshirë ato të natyrës sociale, rekreative, edukative dhe verbale. UNICEF-i, përafërsisht jep një definicion të tillë, pak më të thjeshtë, “Fëmijët me nevoja të veçanta janë ata, të cilët për arsye të ndryshme nuk mund të shfrytëzojnë plotësisht të gjitha aftësitë e tij fizike, mendore dhe sociale ose thënë shkurt të bëjnë veprime dhe aktivitet të rëndomta siç i bëjnë fëmijët tjerë të moshës së njëjtë.”

Gjendja e tillë mund të jetë e lindur, e zhvilluar, ose e fituar nga sëmundjet, traumat, ose nga faktorët mjedisorë dhe ndikon në kufizimin e kryerjes së aktiviteteve të përditshme të jetës. Kujdesi shëndetësor për personat me nevoja të veçanta kërkon njohuri të specializuara, të fituara me trajnime plotësuese, rritje të vetëdijes dhe vëmendjes, adaptim dhe masa akomoduese përtej asaj që konsiderohet rutinë”.

Nga aspektin stomatologjik, te fëmijët me nevoja të veçanta, për shkak të çrregullimeve të përmendura, kërkohet përgatitje paraprake e pacientit, njohuri të larta profesionale të pedodontit dhe kuadrit ndihmës si dhe hapësira dhe aparaturë adekuate stomatologjike.

Doc. Dr. Kenan Ferati

Specialist i kirurgjisë maksilofaciale.

Arsimi:

Fakulteti i stomatologjisë në Universitetin Stomatologjik të Sarajevës dhe
Universiteti i stomatologjisë “St. Kirili dhe Metodi” Shkup,

Studime të doktoratës Universiteti i Kombeve të Bashkuara Beograd

Specializimi i kirurgjisë maksilofaciale në Qendrën Klinike Universitare të Shkupit

Trajnim profesional në lidhje me “Deformimin e kockave dhe trajtimin e tyre” në Universitetin
e Hannoverit

Trajnim profesional në Universitetin e Bazelit dhe institutin Straumman rreth Implantologjisë

Përvojë pune:

Themelues i Poliklinikës Dentare “Apolon” në Tetovë

2010 - 2014 asistent i kirurgjisë maksilofaciale dhe implantologjisë në Universitetin Shtetëror të
Tetovës

Nga viti 2014 docent dhe lektor në kirurgji maksilofaciale dhe implantologji në Universitetin
Shtetëror të Tetovës

2014 - 2016 Prodekan për Edukimin në Fakultetin e Shkencave Mjekësore dhe Shef i programit
të studimit Stomatologji.

Aktuale:

President i shoqërisë shqiptare stomatologjike të Maqedonisë,

Nënkryetar i Dhomës Stomatologjike të Maqedonisë.

Anëtar i EAOCMFS

I.T.I. Ekipi (Ekipi Ndërkombëtar i Implantologjisë)



Pedagog në Ekipin Straumann, Anëtar i Shoqërisë Stomatologjike Shqiptare

Anëtar i kirurgëve maksilofacial të Maqedonisë,

Anëtar i Impantologëve të Maqedonisë.

Konsulent dhe kirurg në “Diamond Clinic” - Shqipëri

Anëtar i komisionit në Dhomën e Stomatologjisë të Maqedonisë

Anëtar i bordit ekzekutiv në Qendrën Simuluese Mjekësore të Maqedonisë

DEFEKTET KOCKORE TË NOFULLAVE - TRETMANI I TYRE

Atrofia e nofullave vjen si rezultat i patologjive të ndryshme orofaciale dhe humbja e dhëmbëve e cila mund të jetë në shkallë të ndryshme.

Trajtimi adekuat i nofullave të atrofuara na jep mundësi të reja në stomatologjinë moderne në përgatitjen e mëtijshme të pacientëve, në sanimin e defekteve kockore, përmirësimin e ndryshimeve në rrafshin horizontal dhe vertical, zëvendësimin e dhëmbëve të humbur, dhe arrijtjen e mirëfilltë të estetikës dhe mastikacionit tek pacientet me nofulla të atrofuara. Në prezentimin tonë do të shpërndajmë eksperiencën tonë në trajtimin e tyre.

Kirurgjia si segment bashkëkohor i mjekësisë dentare, ofron qasje të re terapeutike në zgjidhjen e defekteve kockore të nofullave dhe padhëmbësisë së shkallëve të ndryshme.

Nevoja për rehabilitimin protetikor me implante dentare, ky revolucion shpion në drjetim të zhvillimit të kirurgjisë dhe implantologjisë si degë e veçantë në stomatologjinë moderne e cila i kënaq në tërësi të gjitha kriteret për rritje estetike dhe funksionale të çdo individi. Mirëpo, si të gjitha degët, edhe kjo në rrugëtimin e saj ballafaqohet me probleme dhe sfida të ndryshme në trajtimin e anomalive të ndryshme të lindura apo të fituara gjatë jetës si dhe trajtimin e duhur të tyre. Ndër shqetësimet e shpeshta janë atrofia e maxillës dhe mandibulës.

Prof. Ass. Miranda Stavileci-Veliu

Miranda Stavileci-Veliu u lind në vitin 1975 në Prishtinë. Shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendlindje. Në vitin 2001 diplomoi në Universitetin e Prishtinës, në Fakultetin e Mjekësisë, Dega e Stomatologjisë. Në vitin 2006, në Prishtinë kreu specializimin nga lëmia e Sëmundjeve të Dhëmbit me Endodoncion, me ç'rast u punësua në QKSUK ku punon edhe sot.



Në thirrjen e asistentit të ri u emërua në po të njëjtin vit, për t'u avancuar asistent, në vitin 2010.

Në vitin 2009 në Universitetin e Prishtinës mbrojti temën e magjistraturës me titull: “Mikrodepërtueshmëria e pështymës te mbushjet e kanalit me Mineral Treoksid Agregat”, ndërsa, në vitin 2014, poashtu në Universitetin e Prishtinës mbrojti temën e doktoraturës me titull “Analiza tredimensionale e morfologjisë së dhëmbit me mikrotomografi të kompjuterizuar para dhe pas përpunimit të kanalit të rrënjës”.

Në thirrjen e profesor asistentit, u emërua në tetor të vitit 2018.

Ka marrë pjesë aktive në shumë konferenca stomatologjike kombëtare dhe ndërkombëtare, në të cilat ka prezentuar punime shkencore dhe profesionale. Po ashtu, është autore dhe koautore e disa publikimeve në revistat kombëtare dhe ndërkombëtare.

VLERËSIMI I PËRPUNIMIT DHE OBTURIMIT TË KANALIT ME TEKNIKA TË NDRYSHME.

Përpunimi i kanalit të rrënjës së dhëmbit pa gabime procedurale, si dhe obturimi cilësor janë disa nga qëllimet kryesore për trajtim të suksesshëm endodontik.

Për shkak të sistemit kompleks të kanaleve, shpesh paraqiten dështimet endodontike edhe përkundër aplikimit të instrumenteve dhe teknikave të avancuara, pasojë kjo e kanaleve të patrajtuara, si dhe baktereve të mbetura në ramifikimet apikale, të cilat nuk preken nga procedurat endodontike.

Prandaj, për një trajtim të suksesshëm endodontik, terapeuti jo vetëm që duhet të njeh anatominë e brendshme të dhëmbit me të gjitha variacionet e tij, por ai duhet të jetë edhe i trajnuar për aplikimin e teknikave të ndryshme të përpunimit dhe obturimit të kanaleve.

Në këtë ligjeratë do të flitet për teknikat e ndryshme të përpunimit dhe obturimit të kanaleve, si dhe do të bëhet krahasimi i rezultateve të autorëve të ndryshëm me rezultatet tona.

ENGLISH

The Conference Program

09.45 OPENING OF THE CONFERENCE

PLENARY LECTURES

10.00 – 10.40 LP1 – **Asoc. Prof. Ferit Koçani** (University of Prishtina) - DENTISTRY DURING COVID-19 PANDEMICS

10.50 – 11.30 LP2 – **Asoc. Prof. Edit Xhajanka** (University of Medicine, Tirana) – DETERMINATION OF PROSTHETIC BALANCE SPACE IN REMOVABLE PROSTHESES

11.40 – 12.20 LP3 – **Prof. Dr. Sc. Marinka Mravak Stipetić** (University of Zagreb, Croatia) – CHANGES IN THE ORAL MUCOSA DURING ORTHODONTIC TREATMENT

12.30 – 13.10 LP4 – **Asoc. Prof. Çeljana Toti** (University of Medicine, Tirana) – DENTAL TRAUMA MANAGEMENT IN ORTHODONTICS

13.20 – 14.00 LP5 – **Asst. Prof. Irina Dragan** (Tufts University School of Dental Medicine, USA) - INTEGRATING THE AAP/EFP 2018 CLASSIFICATION INTO CLINICAL PRACTICE

14.00 – 15.00 *Pause*

15.00 – 15.40 LP6 – **Prof. Dr. Agim Begzati** (University of Prishtina) – DENTAL CARE OF CHILDREN WITH SPECIAL NEEDS

15.50 – 16.30 LP7 – **Asst. Prof. Kenan Ferati** (University of Tetova, N. Macedonia) – BONE DEFECTS OF THE JAWS AND THEIR TREATMENT

